



*№. 37 prot  
Shkollorin 20/06/18*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 3      Datë 13. 06. 2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT  
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "V.B.NERGUTI" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni", për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit "V.B.NERGUTI" SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "V.B.NERGUTI" SH.P.K me administrator Z. Tasim NERGUTI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Leshnices**, degë e Lumit Drin për prodhim energjie elektrike në fshatin Surroj, Njësia Administrative Surroj, Bashkia Kukës, Qarku Kukës .

2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

-Mungon një plan kombëtar për përdorimin e burimeve ujore për hidroenergji.

-Shkatërron mjedisin dhe turizmin.

-Vështirëson jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**

**Raimonda GURI**



**KRYETAR**

**Çesk MILLJA**

